



NEWSLETTER

Shtator 2024

Nr.9

Është mbajtur takimi i tretë publikë i ASHMA-së për vitin 2024



Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale më 27 shtator mbajti takimin e tretë publik për këtë vit, në të cilin drejtori dr. Zoran Trajçevski bëri një pasqyrë të aktiviteteve të realizuara në përputhje me Programin vjetor për punë në tre muajt e fundit. Të pranishmit patën rastin të dëgjojnë për aktivitetet që kanë të bëjnë me mbikëqyrjet e realizuara mbi transmetuesit, operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik, botuesve të mediave të shkruara, masave të shqiptuara vërejtje publike, studimeve të përgatitura, aktiviteteve në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në takim u prezantuan edhe gjetjet e Analizës së Tregut të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023. Analiza përmban të dhëna për çështjet ekonomike të transmetuesve, përkatësisht të dhëna për të ardhurat në total, shpenzimet në total, rezultatin financiar të punës dhe numrin mesatar të të punësuarve. Shërbimi publik radiodifuziv dhe transmetuesit komercial së bashku kanë realizuar të ardhura në shumë prej 2.458,57 milionë denarë, prej të cilave 1.000,44 janë të ardhurat e Radio Televizionit të Maqedonisë; 1272.63 të televizioneve dhe 185.50 të radiostacioneve. Mjetet e shpenzuara së bashku nga shërbimi radiodifuziv publik dhe transmetuesit komercialë arritën në 2.708,21 milionë denarë. Fitim kan pasur vetëm radiot komerciale në shumë prej 10,15 milionë denarë. Radiotelevizioni i Maqedonisë ka punuar me humbje prej 131,77 milionë denarë, ndërsa televizioni komercial me humbje prej 139,55 milionë denarë.

Në vijim u diskutua për analizën e strukturës gjinore të pronësisë së televizioneve dhe radiove në periudhën nga viti 2020 deri në vitin 2023, si dhe për strukturën gjinore mes punonjësve të transmetuesve në periudhën nga viti 2019 deri në vitin 2022. Gjetjet treguan se burrat ishin më të shumtë se gratë në të gjitha vitet e analizuar, veçanërisht në pozita udhëheqëse/drejtuuese, në staf teknik dhe realizues, në krahasim me gazetaret femra që tradicionalisht ishin më të shumta se gazetaret. Të dhënat tregojnë një prezencë të caktuar të të ashtuquajturit "tavan qelqi", i cili është tregues i ekzistencës së kufijve informalë që vështirësojnë ngritjen e grave në poste më të larta dhe rrjedhimisht pjesëmarrjen e tyre në proceset vendimmarrëse.

Thirrja publike e përfunduar për përzgjedhjen e personit juridik që ushtron veprimtari ose posedon leje për ushtrimin e veprimtarisë për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve elektrike dhe depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale më 10 shtator publikoi thirrje publike për përzgjedhjen e personit juridik (operatori ekonomik), i cili kryen veprimtari ose posedon leje për kryerjen e veprimtarisë për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve elektronike dhe depozitimin dhe trajtimin e mbeturinave, dhënë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).

Në thirrje mund të konkurrojnë persona juridikë me leje të vlefshme për veprimtarinë që është objekt i kësaj thirrjeje publike ose konsorcium personash juridikë me lejet e specifikuar (leje për kryerjen e veprimtarisë për grumbullimin dhe/ose transportimin e mbetje të rrezikshme dhe lejen për kryerjen e veprimtarisë depozitimin dhe trajtimin e mbeturinave dhënë nga MMPH). Tema e thirrjes publike ishin mbeturinat e objekteve të luajtshme të cilat për shkak të rrënimin, papërdorshmërisë apo vjetërsisë teknologjike nuk përdoren nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Të gjitha informacionet rreth thirrjes publike janë në dispozicion në [linkun](#).

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit për pjesëmarrje ka qenë data 17.09.2024 deri në orën 16:00.

Mbikëqyrja e transmetuesve dhe operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik

Transmetuesit

Për përbushjen e detyrimeve nga neni 62 paragrafi (6) të LSHMAAV dhe nenit 9 dhe 21 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio, mbikëqyrje e rregullt administrative është kryer mbi 13 transmetuesit RA Antena 5, RA Zone M-1, RA Kiss, RA Bleta, RA Modea, RA Super, RA Fortuna, TV Vistel, TV Koha, TV M, TV MTM, TV Edo dhe TV Sitel. Nga mbikëqyrja është konstatuar se transmetuesit i plotësojnë kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio.



NEWSLETTER

Për plotësimin e kushteve minimale kadrovike të Rregullores, është kryer mbikëqyrje e jashtëzakonshme administrative mbi 20 transmetues: RA Jehona, RA 7, RA Xhez FM, RA Urban FM, RA Kometa, RA Merak 5 FM, RA Valandovë, RA Red FM, RA Vat, RA Marija - Blagovest, RA Metropolis, RA Meff, RA Plus Forte, RA Tajm, TV Dibra, TV M-Net HD, TV Protel, TV Plus, TV Tera dhe TV Alsat - M. Nga mbikëqyrja u konstatua se transmetuesit i plotësonin kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio.

Operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik

Agjencia ka kryer mbikëqyrje të rregullta programore mbi operatorët Viva Net, Kombo 2003, Skupi Kable, Transhped Trejd dhe Vinsat Kabel për detyrimin e pakos programore që ata ritransmetojnë detyrimisht dhe pa pagesë për të ofruar falas shërbimet programore të shërbimit publik radiodifuziv dhe për respektimin e detyrimeve për regjistrimin dhe titrimin e shërbimeve programore që operatorët ritransmetojnë. Gjatë mbikëqyrjes është konstatuar se operatori kabllor Kombo 2003 nga Kumanova për shfrytëzuesit e tij është duke ritransmetuar shërbimet programore "Discovery" dhe "Animal Planet", të cilat nuk mbulohen me çertifikatën për regjistrim të shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia.

Agjencia ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore mbi operatorin A1 Maqedonia për respektimin e detyrimeve për regjistrimin e shërbimeve programore dhe titrimin e shërbimeve programore që ata ritransmetojnë, dhe mbi operatorin Total TV për detyrimin e pakos programore që ritransmeton detyrimisht dhe pa pagesë për të ofruar shërbimet programore të shërbimit publik radiodifuziv.

Me mbikëqyrje është konstatuar se operatori A1 Maqedoni për shfrytëzuesit e tij ka ritransmetuar shërbimet programore "TV Shenja", "TV Vistel", "Nickelodeon", "Nick Jr", "Nicktoons", "Epic Drama", "TV 1000", "Klasik TV HR", "Timeless Dizi Channel", "Arena Sport 1", "Arena Sport 2", "Arena Sport 3", "Arena Sport 4", "Arena Sport 5", "Arena Premium 1", "Arena Premium 2", "Arena Premium 3", "Viasat Nature", "Viasat Explorer", "Viasat History", "Museum", "Luxe TV", "Balkan Trip", "RTS Svet", "Agro TV", "Arena Fight", "Al Jazeera", "A TV", "TRT Turk", "Toxic", "Toxic Folk", "Toxic Rap", "MTV 00", "MTV Europe", "MTV Hits", "MTV Life", "Nick Music", "MTV 90", "MTV 80", "Club MTV", "Bloomberg" dhe "Duck TV", të cilat nuk mbulohen me çertifikatë për regjistrim të shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia.

Masat e shqiptuara vërejtje publike

Në seancën e 35-të mbajtur më 12 shtator, Këshilli i Agjencisë për operatorin Kombo 2003 nga Kumanova miratoi aktvendim për paralajmërim publik dhe për përjashtimin e ritransmetimit të shërbimeve programore "Discovery" dhe "Animal Planet", të cilat nuk janë të regjistruara. në Agjenci, në pajtim me nenin 141 të LSHMAAV.

